LAJME / SIGURI

Policia konfiskon mbi 82 kilogramë marihuanë, armë, automjete dhe gjëra të ndryshme- arrestohen gjashtë persona

3 komente

11 orë

Policia e Kosovës në bashkëpunim dhe koordinim me Prokurorinë Shtetit ka realizuar një operacion policor në rajonin e Prishtinës dhe të Gjilanit, i cili ka rezultuar me arrestimin e gjashtë personave të dyshuar dhe konfiskimin e mbi 82 kilogramë substanca narkotike, marihuanë.

Gjatë realizimit të kontrollit në cilësi të provave materiale në lokacione të ndryshme janë gjetur të fshehura në vende dhe mjete të ndryshme, provat e sekuestruara: 82 kilogramë e 914 gramë marihuanë; 100 paketime të barnave të kontrabanduara, me peshë prej 100 kilogramëve e 180 gramëve; 1 pushkë gjuetie me 35 predha (fishekë) si dhe dy qese najloni të mbushura me barot dhe sfera për municion të armës së gjuetisë.

Po ashtu janë sekuestruar: 1 armë e gjatë 'AK- 47' me një karikator, 1 revole 'TT' me një karikator dhe 6 predha (fishekë), 1 dylbi e armës së gjatë, 174 predha (fishekë), 5 vetura të ndryshme, 15.774,50 €, 20 franga zvicerane dhe barna të llojeve të ndryshme.

Personat e dyshuar janë arrestuar dhe me vendim të prokurorit kompetent janë dërguar në mbajtje për 48 orë.

Arrestimi i personave të dyshuar është bërë mbi dyshimin e bazuar për përfshirje në veprat penale "Blerja ,posedimi shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge", "Mbajtja nën kontroll dhe shfrytëzim i paautorizuar i armëve", "Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore dhe pa banderolë" si dhe "Shmangia nga pagesat e detyrueshme doganore ose tarifave akcizore".

Me urdhër të prokurorit kompetent është bërë edhe kontrollimi i katër lokacioneve, prej tyre dy banesa të banimit, njëra në Prishtinë dhe tjetra në Fushë Kosovë, si dhe dy shtëpi në Gjilan së bashku me një objekt përcjellës, të cilat dyshohet se grupi në fjalë i kanë përdorur për fshehje, shitje dhe shpërndarje të narkotikëve, si dhe për kontrabandë të barnave me origjinë të dyshimtë. **/Telegrafi/**

Marihuanë Policia e Kosovës

Lajme Telegrafi
Më të lexuarat në Lajme

Alfred Cako: Këta janë tre masonët e famshëm të Kosovës

Osmani: Dikur u intervistova si refugjate, sot si presidente bëj thirrje të mos i mbyllin dyert për...

Festa e serbëve me flamuj, kryq e "katër S" në Malet e Sharrit

Momenti kur automjeti "Off Road" rrokullistet bjeshkëve të Dukagjinit

Bursat për studimet Bachelor ne Kolegjin CITY, Kampusi i Evropës Universiteti i Jorkut në Selanik
Sponzorizuar
Lexo më shumë

Si të përfitojmë kur vlera e Bitcoin bie?
Sponzorizuar
Lexo më shumë

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2006-2021 Portali Telegrafi